



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA BERAT
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRËNDSHËM

Nr. _____ Prot.

Berat, më _____.11.2022

K O N F I R M O H E T
KRYETARI I BASHKISË
ERVIN DEMO

M E M O

PËR: Z. ERVIN DEMO KRYETARI I BASHKISË BERAT .

NGA : Z. Xhevahir Muzhaka dhe znj. Orieta Hysanj,
Audit në Sektorin e Auditimit të Brëndshëm Publik të Bashkisë Berat.

SUBJEKTI: *Auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në Ndermarrjen e Gjelbërimit ka patur si objekt "Ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zhvillimit të veprimtarisë, përdorimit të burimeve financiare dhe vlerësimit të aktivitetit per periudhën 1 Gusht 2019 -31 Dhjetor 2021.*

Grupi i auditëve e realizoi këtë detyrë gjatë periudhës 12.07.2022 -09.08.2022

Qëllimi i këtij misioni auditimi është vlerësimi i frytshmërisë së menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes, dhënia e sigurisë objektive dhe konsulencës, me synim për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës.

Rreth Projekt Raportit te Auditimit nuk pati asnje observim.

Mbi bazen e Projekt Raportit kemi përpiluar Raporti Final i Auditimit.

Konkluzion :

Në veprimtarinë e Ndermarrjes se Gjelberimit u konstatua se ka permiresim te veprimtarise ekonomiko-financiare. U verejten disa parregullesi lidhur me mjedisin e pergjithshem te kontrollit kryesisht ne ndryshimin e struktures organizative dhe pozicione te punes te paargumentuara me pershkrim konkrete te detyrave, per te cilen kerkohet nje rregullore e perditesuar.

I. Zbatimi i rekomandimeve te lena nga auditimi i meparshem.

Nga rekomandimet e lena nga auditimi i mëparshëm, nga 20 njezet rekomandime te lena, rezulton se jane zbatuar 10 rekomandime, janë në proces zbatimi 8 (tete) dhe pa zbatuar 2 (dy).

Nga 25.409 leke te kerkuara per zhdemtim per dy persona jane zhdemtuar ne mase te plote shuma 25.409 leke nga 2 persona.

II. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit

Për vitet 2019 - 2021 buxheti i njësisë shpenzuese Ndermarja e Gjelberimit Berat është miratuar me VKB-të përkatëse të cdo viti buxhetor, të pasuruara me ndryshimet gjatë vitit buxhetor në zbatim të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,

Nga analiza e buxhetit te v. 2019 konstatohet se shpenzimet per paga e sigurime shoqerore perbejne 88.7 % te shpenzimeve te pergjithshme te ndermarjes se gjelberimit, shpenzimet operative zene 10.7 % dhe shpenzimet per investime zene vetem 0.6% te shpenzimeve te pergjithshme.

Nga shpenzimet operative pjesen me te madhe te buxhetit e perbejne shpenzimet per shpenzimet per

veshje speciale , plehra e e farerave te cilat perbejne 46% te shpenzimeve operative dhe shpenzimet per transportin e pjeset e kembimit perbejne 37.5 % te shpenzimeve operative.

Nga auditimi i buxhetit, planifikimit dhe realizimit të tij per periudhen e auditimit vlerësojmë:

- Është respektuar disiplina buxhetore në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr 9936, date 26.06.200 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.
- Planifikimi i kerkesave buxhetore të PBA-së është bërë brenda afatit ligjor.
- Planifikimi për paga e sigurime shoqërore është hartuar në bazë të struktures së miratuar dhe nivelit te pagave sipas VKM- vet ë miratimit të tyre.
- Treguesit për shpenzime operative vendosen nga eksperiencat e viteve te kaluara.
- Shpenzimet janë justifikuar me dokumenta autorizues dhe vertetues.
- Është respektuar destinacioni i fondeve buxhetore.

Ne artikullin 602 (shpenzime operative) verehet nje realizim prej 70.3% kundrejt shpenzimeve ne total te planifikuara per kete artikull.

Per vitn 2020 konstatojme se shpenzimet operative jane realizuar ne masen 64.5% .

Per vitin 2021 Buxheti i Ndermarrjes se Gjelberimit konstatohet se llogaria 600 paga pune ka nje realizim prej 89.6%, cka ka ardhur nga mosplotesimi i organikes se planifikuar. Totali shpenzime operative operative (llog 602) eshte realizuar ne masen 56.5% , cka deshmon se nuk ka ndjekje si duhet te realizimit te shpenzimeve operative. Realizimi i shpenzimeve te materialeve te zyres dhe te pergjithshme qe nga 140 mije leke te planifikuar realizimi eshte 0%, artikuj veshje special nga 100 mije te programuar eshte realizuar 0 % . Si dhe pjese kembimi , goma e bateri qe nga 400 mije leke te programuara realizimi eshte 0%.

Gjetje:

1. Mangesi ne ndjekjen dhe realizimin e zerave buxhetore kryesisht per artikullin 602 ne menyre analitike, ne kundershtrim me rregullat e percaktuara ne hartimin dhe ndjekjen e buxhetit ne zbatim te Ligjit Nr 57/2016 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9936, Date 26.6.2008, “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne republiken e Shqiperise ”, te ndryshuar, neni 52 ;

Rekomandojme :

1. Te ndiqen te gjitha procedurat ligjore per realizimin e zerit buxhetor te shpenzimeve 602 dhe per rastet e mosrealizimit te analizohen shkaqet dhe te dalin pergjegjesite.

III. Sistemi i menaxhimit të burimeve njëzërore.

Për periudhen e audituar Ndermarrja e Gjelberimit disponon rregullore të brendshme të vitit 2019 të miratuar nga drejtori i institucionit, e pa miratuar nga Kryetari i Bashkise, e cila nuk është e përditësuar për vitin 2020 dhe vitin 2021 për të cilat ka pasur ndryshime të strukturës në vitin 2020 dhe 2021. Strukturat e periudhës së auditimit janë vendimuar nga Kryetari i Bashkisë per periudhen e audituar.

Anomali qe u verejt nga auditimi janë kontratat e punës së punonjësve, për të cilat është konstatuar anomali në rinovim edhe nga auditimi i mëparshëm. Auditimi mori me përzgjedhje 25 prej tyre dhe konstatoi mangësi në 12 prej tyre: Disa janë përpiluar nga juristi në detyrë, pa afat, por nuk janë konfirmuar nga titullari i bashkisë: Disa kontrata kanë afat fillimi dhe mbarimi të periudhës së punës dhe nuk janë rinovuar në vazhdimësi; Për të gjitha kontratat e mesipërme, si në mbarim të periudhës së kontraktimit dhe ato të mos miratimit të kryetarit të bashkisë, nuk gjendet vendim i titullarait që duhet të korrespondonte me kontratën e punës. Gjithashtu edhe nga Ndërmarrja e Gjelbërimit nuk u gjet relacion që ben me dije bashkinë për situatën e paqartë kontraktuale të punonjësve të saj. Punonjësit janë ende në marrëdhënie pune me kontratë pune e cila ose është me afat të përfunduar ose është me kontratë të pamiruar nga kryetari i bashkisë.

Gjetje:

2. Për periudhën e audituar nuk gjendet rregullorja e brendshme e përditësuar për vitin 2020 dhe 2021 me pozicionet e ristrukturuara të strukturave përkatëse, por është punuar me rregulloren e vitit 2019, e cila nuk është e miratuar nga kryetari i bashkisë Berat;
3. Kontratat e punës për disa punonjës nuk kanë të gjithë elementet e duhur dhe punonjësit janë ende në marrëdhënie pune me kontratë pune e cila ose është me afat të përfunduar ose është me kontratë të pamiruar nga kryetari i bashkisë;

Rekomandojmë:

2. Nga Bashkia Berat të përditësohet rregullorja e brendshme për Sektorin e Gjelbërimit në zbatim të nenit 64 germa j të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
3. Nga Bashkia Berat dhe nga Agjensia e Shërbimeve Publike të rishihen të gjitha dosjet e personelit të cilat kanë mangësi në elementet kontraktuale në zbatim të nenit 21 të Kodit të Punës;

Shpenzimet e karburantit

Nga auditimi i dokumentacionit mbi normativën e konsumit të karburantit për periudhën e audituar rezultoi së është punuar me normativat e proces-verbalit të mëparshme dhe respektivisht me proces – verbalet nr. 9, datë 09.01.2018

Nga kqyrja e dokumentacionit, u konstatua se nga financa është kryer analiza e shpenzimeve të karburantit vetëm për karburantin gazoil, i cili ka edhe konsumin më të madh të përdorimit. Për benzinën, nga specialist i gjelbërimit dhe nga tërheqësi i benzinës është mbajtur proces- verbal në lidhje me vendin ku do të kryhet korrja e barit, sipërfaqen, oret e punës dhe ditët që janë punuar në bazë të urdhërit të punës. Ky proces-verbal gjendet në dokumentat e magazinës dhe nuk është kryer nga financa analizës e saj e shpenzimit.

Mangësitë e konstatuara gjatë auditimit në lidhje me harxhimin e karburantit:

- Për 2 (dy) automjete, gjendja në fund të analizës është me diferencë negative, fakt ky që është i pamundur të ndodhi. Ne mungesë të një kontrolli nga financa/specialist finance në lidhje me vërtetësinë e km të përshkruar në fletët e udhëtimit, anomalira të tilla do të jenë prezente dhe **nuk të vërtetojnë kryerjen faktike** të lëvizjeve të mjetit në funksion të shërbimeve të ndërmarrjes;
- Mos ndjekje nga financa e shpenzimeve të benzinës për mjetet të cilat janë në përditshmëri të punës së punonjësve të gjelbërimit duke kontabizuar shpenzimin e saj vetëm me proces-verbalin e hartuar nga punonjësit përgjegjës. Karburanti-benzinë, si zë shpenzimi është i lënë totalisht jashtë kontrollit të financës duke u limituar vetëm nga kjo e fundit për “veprimin aritmetik” të km të vendosura nga hartuesi i fletës së udhëtimit;
- Normativa e konsumit të karburantit është llogaritur me proces-verbalin e hartuar në vitin 2018, normativë e cila duhet të ishte riparë nga institucioni për shkak të kohës së gjatë të monitorimit të saj;

Gjetje:

- 4.Për 2 (dy) automjete, gjendja në fund të analizës është me diferencë negative, fakt ky që është i pamundur të ndodhi, prezenca e te cilit nuk të vërteton kryerjen faktike të lëvizjeve të mjetit në funksion të shërbimeve të ndërmarrjes;
- 5.Mungon analiza e shpenzimit të benzinës për mjetet të cilat janë në përditshmëri të punës së punonjësve të gjelbërimit;
- 6.Normativa e konsumit të karburantit është llogaritur me proces-verbalin e hartuar në vitin 2018, normativë e cila duhet të ishte riparë nga institucioni;

Rekomandojmë:

4. Nga nëpunësi zbatues të kryhet në kohë analiza e shpenzimit të karburantit-gazoil dhe të analizohen arsyet e diferencës negative të analizës;
5. Nga nëpunësi zbatues (personat që e kanë detyrë funksionale në rregulloren e miratuar nga drejtuesi i Institucionit) të ndiqet edhe analiza e shpenzimeve të karburantit -benzinë pas faktit në zbatim të nenit 12 pika 3, germa e “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe neni 22 “Veprimtaritë e Kontrollit” pika 4;
6. Nga Agjensia e Shërbimeve Publike të rishihet normativa e konsumit të karburantit të automjeteve dhe asetëve të tjera në inventar të Ndërmarrjes së Gjelbërimit në zbatim të pikës 2, nenit 9 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar

IV. Sistemi i kontabilitetit dhe i raportimit financiar

1. U audituar pasqyrat financiare te viteve te auditimit 2019, 2020, nga ku rezultoi se jane depozituar ne kohë, pranuar e miratuar nga pergjegjesi i Deges se Thesarit Berat brenda afatit kohor.

Nga auditimi i pasqyrat financiare te vitit 2019 u konstatua se ne llogarine 215 mjete transporti si ne periudhen paraardhese te vitit 2018 dhe ate te viteve te auditimit 2019-2021, u konstatua se vlera e mjeteve te transportit eshte 0, kur Ndermarja e Gjelberimit ka 2 mjete transporti ne perdorim.

E pyetur per vleren e kontabilitetit te mjeteve te transporti 0 kur ato jane ne funksionim pergjegjesja e finances e argumenton se mjetet jane amortizuar 100 % dhe se vlera e mbetur spas normave te amorizimit te meparshem kane qene amortizimi linear dhe baze ka qene vlera historike.

Gjetje nr7:

Nga auditimi i pasqyrat financiare te vitit 2019 u konstatua se ne llogarine 215 mjete transporti si ne periudhen paraardhese te vitit 2018 dhe ate te viteve te auditimit 2019-2021, u konstatua se vlera e mjeteve te transportit eshte 0, kur Ndermarja e Gjelberimit ka 2 mjete transporti ne perdorim.

E pyetur per vleren e kontabilitetit te mjeteve te transporti 0 kur ato jane ne funksionim pergjegjesja e finances e argumenton se mjetet jane amortizuar 100 % dhe se vlera e mbetur spas normave te amorizimit te meparshem kane qene amortizimi linear dhe baze ka qene vlera historike.

Veprimi i mesiperem perben shkelje te Udhëzimit nr. 30 date 27.12.2011 "Per Menaxhimin e Aktiveve ne njesite e sektorit publik", te ndryshuar ku ne kapitullin II. Menaxhimi i Riskut te lidhur me aktivet, pika 23, ku thuhet: *"Jetëgjatësia standarte që jepet në regjistrin e aktiveve afatgjata nëpërmjet normave të amortizimit është një tregues se kur një aktiv duhet të zëvendësohet. Është e rëndësishme që jetëgjatësia standarte të mos ndiqet verbazi, pasi aktiv mund të vazhdojë të jetë në gjendje pune dhe njëkohësisht i nevojshëm ose i dobishëm për plotësimin e objektivave të njësisë. Dobishmëria e cdo aktiv duhet vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, i cili ngrihet dhe funksionon sipas kriterëve të këtij udhëzimi"*

Rekomandimi nr 7: Te ngrihet komisioni I vlerësimit te mjeteve ne perdorim mbeshetur ne Udhëzimit nr. 30 date 27.12.2011 "Per Menaxhimin e Aktiveve ne njesite e sektorit publik", te ndryshuar ku ne kapitullin II. Menaxhimi i Riskut te lidhur me aktivet, pika 23,

V. Procesi i inventarizimit dhe vlerësimit te asetëve

U auditua procedura e inventarizimit dhe vlerësimit të asetëve për vitin 2019, vitin 2020 dhe vitin 2021 të hartuar nga njësia shpenzuese në mbështetje të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Nga auditimi i inventarizimit sipas personave dhe nr e llogarive perkatese rezultoi se fletet e inventarit ishin pa korigjime, dhe e ndare sipas llogarive perkatese si dhe firmosur nga personi pergjegjes material dhe nga komisioni i inventarizimit. i perbere nga 5 antare.

Permbledhësja e inventarit eshte e kuadruar sipas llogarive perkatese dhe personave.

Nga auditimi per periudhen e audituar u konstatua se:

Gjetje:

8. Nuk ka nje proces verbal inventarizimi ku te percaktohet numrat rendor te fundit te fletehyrjeve dhe flete daljeve, si edhe mbyllja dhe dyllosja e magazines midis pergjegjesit material dhe komisionit te inventarizimit ne zbatim te Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public" pika 83.
9. Ne fletet e inventarizimit te llogarise 218 nuk percaktohet marka dhe specifikime te tjera te kompjuterave, printerave e artikuj te tjere qe inventarizohen ne kundershtim me piken 42 Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public" I ndryshuar.

Rekomandojme:

8. Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material.
9. Ne fletet e inventarit per aktivet e qendrueshme te percaktohen marka apo specifikime te tjera qe e ben nje aktiv te dallueshem nga te tjeret sipas llojit dhe plotesise se tyre.

VI. Sistemi i prokurimit, pagesave dhe veprimet e likuidimit me banke

Nga auditimi i dokumentacionit të bankes për periudhën 01.08.2019 – 31.12.2021, u konstatua se urdher shpenzimet janë regjistruara në ditarin e bankes dhe të shpenzimeve në mënyrë kronologjike për të gjithë periudhën.

Veprimet e pagesave janë shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm justifikues si urdher shpenzimet të nënshkruara nga nepunësi autorizues dhe zbatues i njesise, dosjen e prokurimit të shoqëruar edhe me gjurme auditimi në rastet e prokurimeve elektronike deri në 800000 leke dhe proces verbalin e blerjes në rastet e prokurimit deri në 100.000 leke, faturen tatimore dhe dokumentin vertetues (flete hyrje). Në rastet e blerjeve u pa se është mbajtur procesverbali i marrjes në dorezim të mallrave i ngritur me urdher të drejtorit çdo fillim viti. U audituan të gjitha flete hyrjet dhe flete daljet për periudhën e auditimit nga u konstatua se janë hartuar ditaret e magazines për hyrjet dhe daljet. Gjithashtu magazinieri ben ngarkimet dhe shkarkimet e magazines duke e pasqyruar veprimin në librin e magazines. Çdo fund muaji bëhej rakordimi i magazines në vlerë dhe sasi nga nepunësi zbatues dhe magazinieri.

Nga auditimi i shpenzimeve për udhëtim e dieta rezultoi se për periudhën e auditimit nuk janë kryer shpenzime për udhëtim e dieta.

Në procedurat e prokurimit publik të kryer është respektuar ligji nr 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligjin nr 162/2020 “Për prokurimin Publik”, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ndryshuar me VKM nr 918, datë 29.12.2014 “për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, si dhe Udhezimi nr 5, datë 11.01.2018” Për një shtesë në Udhezimin nr 3, dt 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Prokurimi është kryer mbështetur mbi kërkesën e përpiluar për nevojat për mallra dhe shërbime dhe të miratuara nga drejtuesi i Ndermarrjes Gjellberimit. Është mbajtur procesverbali i përcaktimit të fondit limitit i cili është bërë nëpërmjet testimit të tregut nga tre antare, ka dalë urdheri i prokurimit nga drejtori i njesise, është hartuar procesverbali i prokurimit dhe marrjes në dorezim të mallrave nga komisioni i marrjes në dorezim i përbërë nga 4 antare.

VII. Auditimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

U vlerësuan të 5 komponentet e kontrollit të brendshëm. *Nga auditimi i plote i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe performancës së Ndermarrjes së Gjellberimit përcaktohet Risk i Mesëm në këtë fushë.*

Nga ish dermarja e Gjellberimit është dërguar Plani i Veprimit mbi zbatimin e Rekomandimeve të Auditit të Brendshëm, dërguar Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Berat, brenda afatit 1 (një) muaj nga dërgimi i Raportit Final të Auditimit, ku janë pranuar të gjitha rekomandimet, personat përgjegjës mbi zbatimin e tyre si dhe afatet e realizimit.

Duke Ju falenderuar,

AUDITI I BRENDSHËM

Xhevahir MUZHAKA

Orieta HYSANJ